



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.9.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË SHTËRPCËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Shtërpcës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Faruk Rrahmani i mbështetur nga, Faik Thaçi (Udhëheqës Ekipi), Enver Ramadani dhe Milosh Petroviq

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	11
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	12
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	25
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	28

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për Komunën e Shtërpcës për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë, Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në Sektorin Publik të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë e reflekton qasjen e paraqitur në Memorandumin e Planifikimit të datës 02.10.2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyra financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012, dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komunës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit dhe Auditimin e Brendshëm).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I sqaron llojet e ndryshme të Opinioneve të aplikuara nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuritë në pronësi të komunës nuk janë identifikuar dhe regjistruar në mënyrën e duhur, duke rezultuar kështu në anomali materiale në shënimet e pasurive në Pasqyra Vjetore Financiare.

Pasuritë mbi 1,000€ në totalin prej 2,477,217€ ishin regjistruar në sistemin e-Pasuria, por jo në regjistrin kontabël dhe në Pasqyra Vjetore Financiare. Po ashtu, dhjetë vetura të komunës me vlerë mbi 1,000€ nuk janë regjistruar fare në regjistrin kontabël.

(SNISA 200: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se, menaxhmenti i komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, por këto kontrolle nuk kishin funksionuar në mënyrë efektive në disa fusha të menaxhimit financiar. Në veçanti ne identifikuam këto mangësi:

- Mos prezantimi i plotë i pasurive financiare në Pasqyra vjetore financiare reflekton dobësi në kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e pasurive;
- Mungesa e një procesi sistematik për menaxhimin dhe implementimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm;
- Dobësitë në procedurat e qeverisjes së përgjithshme kanë reflektuar në raportim menaxherial të cilësisë së dobët;
- Janë mbledhur vetëm 55% të të hyrave të planifikuara me një total prej 70,000€ më pak sesa në 2012. Ekzekutimi i buxhetit në shumicën e kategorive të shpenzimeve ishte i dobët;
- Në procedurat e prokurimit ekzistojnë një sërë dobësishë sistematike të cilat mund të rezultojnë me vonesa në projekte, vlerë të dobët për para dhe mos përmbushje të kërkesave të cilësisë; dhe

- Kontrollë të dobëta ekzistojnë edhe në menaxhimin e detyrimeve. Komuna ka prezantuar mbi 1 milionë euro detyrime të pa paguara. Kjo paraqet gati 1/3 e buxhetit vjetor dhe mund të sjellë komunën në vështirësi serioze financiare në të ardhmen.

Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm janë se, Kryetari duhet të:

- Analizojë arsyet si për keq-deklarimin fillestar të pasurive ashtu edhe për mos ndjekjen e këshillave të dhëna në fazën e ndërmjetme për adresimin e tyre. Duhet të mirren masa të duhura për të siguruar shpalosje të saktë të pasurive në Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2014 mbështetur me funksionim efektiv të komisionit të inventarizimit me kohë;
- Sigurojë se një plan i veprimit, i rishikuar, përcakton qartë një afat kohor praktik por sfidues për adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe. Zbatimi i planit duhet të rishikohet nga Kryetari në baza tremujore;
- Zbatojë një rishikim për të përcaktuar formatin e raportimit financiar për menaxhmentin e lartë që është kërkesë për mbështetjen e një menaxhimi efektiv të punës. Kjo duhet të mbështetet nga një strukturë qeverisëse ku menaxhmenti i lartë është i njoftuar mbi dobësitë e kontrolleve dhe t'i menaxhojë ato në mënyrë aktive;
- Sigurojë se përgatitja e buxhetit paraprihet me një proces rigoroz të vlerësimit i cili pasqyron në mënyrë të plotë informatat, përfshirë shpenzimet e vitit të kaluar / sfidat e pritura të vitit, etj. Monitorimi duhet të aplikohet aty ku masat janë ndërmarrë me kohë për t'i adresuar variancat kundrejt shpenzimeve të planifikuara;
- Zbatojë rishikim sistematik për të përcaktuar barrierat për rritjen e shkallës aktuale të inkasimit të të hyrave dhe për zvogëlimin e shkallës së borxheve historike si dhe të identifikojë mundësitë për përmirësim të situatës. Referenca duhet të bëhen me komunat tjera të ngjashme për të përcaktuar nëse praktikrat efektive në vende të tjera mund të zbatohen në nivel lokal;
- Zbatojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar se përse disa kërkesa specifike të prokurimit nuk adresohen të gjitha prokurimet dhe të zbatojë kontrolle të zgjeruara për të siguruar që të gjitha dobësitë sistematike adresohen; dhe
- Bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe Qeverinë për të siguruar zgjidhjen e kësaj situate. Për më tepër, Kryetari i Komunës duhet patjetër të ndërpres praktikën e hyrjes në obligime para se fondet të jenë zotuar.

Përgjigja e menaxhmentit – Auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të përgatis Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) në PVF.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i Pamodifikuar¹ me Theksim të Çështjes

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuritë në pronësi të komunës nuk janë identifikuar dhe regjistruar në mënyrën e duhur, duke rezultuar kështu në anomali materiale në shënimet e pasurive në Pasqyra Vjetore Financiare.

Pasuritë mbi 1,000€ në totalin prej 2,477,217€ ishin regjistruar në sistemin e-Pasuria, por jo në regjistrin kontabël dhe në Pasqyra Vjetore Financiare. Po ashtu, dhjetë (10) vetura të komunës me vlerë mbi 1,000€ nuk janë regjistruar fare në regjistrin kontabël.

(SNISA 200 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (SNISA 200). Për më tutje referohu në shtojcën I.

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, janë identifikuar dy rreziqe domethënëse që kanë ndikim në PVF: atë për plotësinë e pasurive dhe shpalosjen e pagesave nga palët e treta. Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku në lidhje me shpalosjet dhe prezantimin e pagesave nga palët e treta nuk ka ndodhur. Menaxhmenti i Komunës e ka trajtuar drejt këtë rrezik dhe ka arritur që këto pagesa t'i prezantojë në PVF dhe të ofrojë shpalosje të duhura për pagesat e palëve të treta.

Çështja 1 - Pasuritë nën pronësi të komunës nuk janë identifikuar dhe regjistruar drejt, duke rezultuar kështu në anomali materiale në shënimet e pasurive në PVF.

E gjetura

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e pasurive. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet të ndërmerret për të siguruar që shifrat e pasurive në PVF të jenë të sakta. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të prezantuara në PVF janë materialisht të pasakta.

Pasuritë në pronësi të Komunës nuk janë identifikuar dhe regjistruar në regjistrin e pasurive. Për shembull, dhjetë (10) vetura të komunës me vlerë mbi 1,000€ nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël. Një vlerë prej €2,477,217 e pasurive mbi 1,000€ ishte e regjistruar në sistemin e-Pasuria por jo në regjistrin kontabël dhe PVF.

Për më tepër, nuk është ndërmarrë asnjë vlerësim i pasurive në fund vit për të konfirmuar plotësinë dhe regjistrimin me kohë të të gjitha pasurive të komunës. Komisioni i inventarizimit të pasurisë ishte themeluar më 07.02.2014 dhe nuk ka kryer ndonjë detyrë deri më sot.

Rekomandimi 1 Prioriteti i Lartë - Kryetari duhet t'i analizojë arsyet si për keq-deklarimin fillestar të pasurive ashtu edhe për mos ndjekjen e këshillave të ZAP-it në fazën e ndërmjetme për adresimin e tyre. Duhet të merren masa të duhura për të siguruar shpalosje të saktë të pasurive në PVF të vitit 2014 mbështetur me funksionim efektiv dhe me kohë të komisionit të inventarizimit.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike nr. 03/L-048;
- Kornizën kohore për dorëzim në Ministrinë e Financave (MF);
- Kërkesën që PVF-të, të jenë të nënshkruara nga ZKA (Kryetari Komunës) dhe ZKF;
- Kërkesën që PVF-të, të jenë të përgatitura në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore te Kuvendi Komunal dhe në MF-së.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur për shkak se çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet se paraqet gjendjen e plotë dhe të saktë të llogarive dhe përmban shënime shpjeguese të mjaftueshme.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga Komuna kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm duke përfshirë:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Drafti dhe plani i prokurimit;
- Raportet mbi borxhet; dhe
- Planin i Veprimit për implementimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto, pasi që komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet për raportim të jashtëm dhe afatet kohore.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Megjithëse, menaxhmenti i komunës kishte përgatitur planin për adresimin e rekomandimeve tona të dhëna në vitin e kaluar, implementimi i tyre i plotë ende mbetet i pakryer. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II

Përshkrimi

Raporti jonë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 ka rezultuar me 14 rekomandime kryesore. Në fund të auditimit kemi vërejtur se shtatë rekomandime janë adresuar plotësisht, pesë janë në proces të adresimit, ndërsa dy nuk janë adresuar fare.

Çështja 2 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Vetëm gjysma e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse Komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së.
- Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve të AP-së në sistemet financiare do të rezultojë në vazhdimin e menaxhimit dhe regjistrimit të dobët të pasurive, kontroll të dobët mbi pagesat e subvencioneve dhe joefikasitet në aktivitetet operative të Komunës.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga ZAP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Planin e implementimit duhet të rishikohet nga Kryetari i komunës në baza tremujore.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më të ulët.

Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, mirëpo nuk po zbatohen në praktikë dhe nuk po funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Megjithëse menaxhmenti ka implementuar një sërë kontrollesh të brendshme në sistemet financiare kyçe, ne kemi gjetur se kontrollet mbi të hyrat nuk po zbatohen në mënyrë efektive. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve po ashtu kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projektit. Fushat ku nevojiten më shumë përmirësime janë: prokurimi, të hyrat, subvencionet dhe menaxhimi i pasurisë.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur të menaxhmentit.

Çështja 3 - Dobësi në kontrollet e menaxhmentit të lartë - Prioritet i lartë

E gjetura Formati i aplikuar i raporteve për menaxhmentin e lartë nuk ofron shpjegime rreth dallimeve në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore.

Rreziku Cilësia e dobët e raportimit financiar mund të zvogëlojë aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës, për të reaguar ndaj sfidave financiare në kohën e duhur dhe për të zbatuar kontrollin efektiv të buxhetit.

Rekomandimi 3 Kryetari të zbatojë një rishikim për të përcaktuar formatin e raportimit financiar për menaxhmentin e lartë që është kërkesë për mbështetjen e një menaxhimi efektiv të punës. Kjo duhet të mbështetet nga një strukturë qeverisëse ku menaxhmenti i lartë është i njoftuar mbi dobësitë e kontrolleve dhe ti menaxhojë ato në mënyrë aktive.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për Komunën shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	3,269,955	3,570,778	2,975,238	4,003,868	3,890,375
Granti i Qeverisë -Buxheti	2,979,955	3,149,955	2,732,894	3,764,988	3,625,023
Të bartura nga viti paraprak ³ -	0	95,728	94,326	50,745	50,675
Të hyrat vetanake ⁴	290,000	290,000	113,121	136,698	185,773
Donacionet e jashtme	0	35,095	34,897	51,437	28,904

Buxheti final, është më i lartë se buxhetin fillestar për 300,823€ si rezultat i të hyrat vetanake të paplanifikuara të bartura nga viti i kaluar dhe donacionet e jashtme. Po ashtu në këtë rritje ka ndikuar edhe rritja me rishikim të buxhetit ku komunës i janë ndarë edhe 100,000€ dhe 70,000€ i janë transferuar nga Ministria e Tregtisë

Në vitin 2013, Komuna ka shpenzuar 83% të buxhetit final, që ishte dukshëm më pak se në vitin 2012 (92%).

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Të hyrat e planifikuara dhe të inkasuara në vitin vijues.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (€)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	3,269,955	3,570,778	2,975,239	4,003,868	3,890,375
Pagat dhe Mëditjet	1,796,000	1,796,000	1,450,596	1,434,355	1,338,840
Mallrat dhe Shërbimet	368,125	497,669	439,266	334,963	340,372
Shërbimet komunale	95,972	95,971	95,970	82,546	55,941
Subvencionet dhe Transferet	57,500	57,500	7,484	4,999	10,314
Investimet Kapitale	952,358	1,123,638	981,923	2,147,005	2,144,908

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Përkundër rritjes së buxhetit për investime kapitale në vlerë 171,280€ gjatë vitit, vetëm 87% ishte shpenzuar kryesisht për shkak të nivelit të ultë të inkasimit të të hyrave vetjake dhe mos pagesës së faturave në vlera të plota;
- Suficiti për paga dhe mëditje (19%) ka rezultuar për shkak të mos rekrutimit të stafit nga Shëndetësia sekondare ngase funksionalizimi i spitalit ende nuk ka ndodhur;
- Buxheti për subvencione ishte shpenzuar vetëm 13% nga ajo që ishte planifikuar për shkak të nivelit të ulët të inkasimit të të hyrave vetanake. Menaxhmenti nuk kishte marrë në konsideratë rialokimet buxhetore me rishikimin e buxhetit;
- Suficiti për mallra dhe shërbime në vlerë 58,403€ ka ndodhur për shkak të një financimi shtesë nga Qeveria që ka ndodhur në nëntor të vitit 2013 dhe për shkak se Komuna nuk ishte në gjendje që të vë të gjitha në përdorim para fundit të vitit; dhe
- Çdo vit, të hyrat vetanake nuk shpenzohen si rezultat direkt i mos ekzekutimit të buxhetit duke pas parasysh se të hyrat vetanake janë burimi i fundit financiar i përdorur. Në vitin 2014 vlera e bartur e të hyrave ka qenë rreth 48,410€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2013 (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimet	2012 Pranimet	2011 Pranimet
Të hyrat vetanake	290,000	290,000	160,126	231,840	114,000

Tabela më lart reflekton një shkallë të dobët të inkasimit në krahasim me të hyrat e planifikuara (55%). Komuna nuk ka demonstruar konsistencë në planifikimin e burimeve të të hyrave. Variancat në tri vitet e fundit janë të theksuara, për 70,000€ më pak se në 2012 dhe 1/3 e vlerës së faturuar të tatimit në pronë nuk ishte inkasuar nga tatimpaguesit.

Menaxhmenti i komunës nuk kanë qenë në gjendje të shpjegojnë lëvizjet në të hyra si në aspektin e projeksioneve buxhetore dhe të hyrave të pranuar.

Çështja 4. Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

E gjetura Komuna për periudhën raportuese, nuk ka pasur performancë të mirë qoftë në shpenzimin e buxhetit apo mbledhjen e të hyrave.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët i buxhetit sidhe shkalla e ulët e të hyrave vetanake mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës (shpenzimet e planifikuara) dhe mund të rezultojë në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet të sigurojë se përgatitja e buxhetit paraprihet me një proces rigoroz të vlerësimit i cili pasqyron në mënyrë të plotë informatat përfshirë shpenzimet e vitit të kaluar / sfidat e pritura të vitit, etj. Theks i veçantë duhet të vendoset në identifikimin e barrierave dhe mundësive në rritjen e shkallës së ekzekutimit të investimeve kapitale dhe veprime të duhura duhet të merren për të adresuar këto pengesa dhe të shfrytëzohen mundësitë e identifikuara. Monitorimi efektiv gjatë vitit buxhetor duhet të aplikohet kur një veprim në kohë është marrë për të adresuar variancat kundrejt shpenzimeve të planifikuara.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Komuna inkason të hyra kryesisht nga tatimi në pronë, taksat e biznesit, gjobat e gjykatave dhe të policisë. Siç është cekur në seksionin 4.2 të hyrat kanë rënë nga 2013 dhe ka nevojë për përmirësim të mëtejme në disa procese për ta mbështetur plotësinë e mbledhjes së të hyrave.

Çështja 5 - Tatim në Pronë - Prioritet i Lartë

E gjetura Komuna nga tatimi në pronë për vitin 2013 kishte planifikuar të inkasoj 45,000€, ndërsa ka inkasuar 59,754€. Totali i borxheve historike lidhur me tatimin në pronë tani është 949,188€.

Rreziku Mos planifikimi për të inkasuar të hyrat në afat do të rrisë potencialin për mos pagesën e faturave të ngritura dhe mungesa e një strategjie efektive për të mbledhur borxhin historik do të zvogëlojë aftësinë e Komunës për të ofruar projekte të vetë-financuara dhe për të përmbushur planet e tjera të shpenzimeve.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të zbatojë rishikim sistematik për të përcaktuar barrierat për rritjen e shkallës aktuale të inkasimit të të hyrave dhe për zvogëlimin e shkallës së borxheve historike si dhe të identifikojë mundësitë për përmirësim të situatës. Referenca duhet të bëhen me komunat tjera të ngjashme për të përcaktuar nëse praktikrat efektive në vende të tjera mund të zbatohen në nivel lokal.

Çështja 6 - Të Hyrat nga taksat e biznesit - Prioritet i mesëm

E gjetura Në territorin e Komunës 651 biznese të regjistruara zhvillojnë veprimtari biznese. Shumica prej tyre janë biznese jo aktive, kurse vetëm 181 janë të pajisura me leje për zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Vlera e faturave të taksës për biznes për vitin 2013 është 52,957€, ndërsa janë realizuar 11,382€. Borxhet historike tani janë 74,565€.

Rreziku Dështimi për të identifikuar në mënyrë sistematike numrin e bizneseve aktive për të dhënë leje të biznesit do të reduktojë një rimëkëmbje të tatimit të biznesit i cili do të ketë një efekt negativ në planet e shpenzimeve.

Rekomandimi 6 Kryetari të zbatojë një rishikim sistematik për të përcaktuar bizneset aktive në komunë dhe për të siguruar që të gjithë të kenë leje të biznesit dhe janë faturuar për tatimin e biznesit në vitin 2014.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Në vitin 2013 nga kategoria e investimeve kapitale janë shpenzuar 981,923€. Ne testuam gjithsej 34 mostra ose 40% të investimeve kapitale që kapin vlerën prej 393,226€ dhe i kemi identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja 7. - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

E gjetura	Dobësitë e zakonshme në procesin e prokurimit janë si në vijim: <ul style="list-style-type: none">• Mbi 30% e faturave të operatorëve ekonomik (OE) nuk janë paguar në shumë të plotë për shkak se fondet e zotuar në projekte kanë qenë më pak se kostot e planifikuara;• Në dy kontrata "Rregullimi i rrugës Markagine" dhe "Asfaltimi i rrugës Jazhincë - Svece" kishte zotim të pamjaftueshëm për përmbushjen e kontratës.• Në katër projekte vlera e përgjithshme e të cilave ishte 25,684€ punët ishin kryer pa u zhvilluar procedurat e prokurimit dhe pa u lidhur ndonjë kontratë pune në mes Komunës dhe OE. Sipas zyrtarëve kjo kishte ndodhur pasi që ishin kërkuar punë urgjente. Po ashtu në disa projekte nuk kishte as raport të pranimit të punëve.
Rreziku	Lidhja e kontratave pa zotim të mjaftueshëm, shmangia nga procedurat e prokurimit dhe pagesat jo në përputhje me faturat mund të rezultojë në projekte të papërfunduara, mos arritjen e cilësisë së kërkuar dhe vlerë të dobët për para. Këto mund poashtu të rezultojnë në masa ligjore kundër Komunës të ndërmarra nga OE-të dhe /apo obligimet e vitit aktual të paguhet nga buxhetet e ardhme.
Rekomandimi 7	Kryetari duhet të zbatojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar se përse disa kërkesa specifike të prokurimit nuk adresohen tek të gjitha prokurimet dhe të zbatojë kontrolle të zgjeruara për të siguruar që të gjitha dobësitë e identifikuar sistematike janë adresuar në mënyrë efektive.

Çështja 8. - Dobësitë jo sistematike të prokurimit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Proceset tjera të prokurimit kanë nxjerrë në pah dobësi specifike të kontrolleve.
- Kontrata e datës 22.08.2012 për furnizim me derivatet, në nenin 4 ka paraparë që çmimet e derivateve do të ndryshojnë sipas çmimeve në bursë. Megjithatë, operatori i ka ndryshuar duke i rritur çmimet në faturë pa bashkangjitur ndonjë dëshmi të ndryshimit të çmimit në bursë; dhe
 - Kontrata “Asfaltimi i rrugës Jazhincë – Svece” në vlerë prej 146,271€ përbëhet nga një operator pa licencë të vlefshme (të skaduar) për sigurimin e bazës për asfalt.
- Rreziku** Pranimi i rritjes së çmimeve pa dëshmi mbështetëse mund të rezultojë me pagesa të parregullta dhe humbje financiare për Komunën. Përzgjedhja e OE-ve të papërgjegjshëm mund të rezultojë në shërbime të ofruara të cilat nuk përmbushin kërkesat e cilësisë.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit janë aplikuar në mënyrë jokonsistente në rastet e mësipërme dhe të zbatojë kontrolle të zgjeruara për të siguruar që një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet, dhe të ndërmeren masa administrative sipas nevojës.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Çështja 9 - Qiraja Komunale - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna ka marr me qira një hapësirë për 580€ në muaj. Për pesë muaj komuna kishte ndalur tatimin në burim dhe të njëjtin ia kishte paguar Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa në shtatë pagesa, OE ishte paguar në shuma të plota.

Përkundër që Komuna merr hapësirë shtesë me qira për akomodimin e stafit, kati i katërt i Komunës shfrytëzohet nga stafi i cili punon për institucione të Serbisë, të cilët nuk paguajnë qira për hapësirën që e shfrytëzojnë.

Rreziku Mos mbajtja e tatimit në burim nga pagesat e qirasë mund të rezultojë në të hyra të reduktuara në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe rrit rrezikun e operatorëve t'i shmangen detyrimit të pagesës së tatimit në qira. Lejimi i stafit jo-komunal për të përdorur objektet komunale pa pagesë rrit shpenzimet e përgjithshme të akomodimit për komunën dhe zvogëlon aftësinë e saj për të shpenzuar para për aktivitetet e drejtpërdrejta për mbështetjen e qytetarëve të saj.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pagesat e ardhshme për qira bëhen neto nga tatimi në burim dhe aty ku është praktike të sigurojë se të gjitha ndërtesat komunale përdoren vetëm për aktivitetet e komunës. Përdoruesit që nuk janë pjesë e komunës duhet të ngarkohen me një qira sipas tregut.

Çështja 10. - Menaxhimi i automjeteve - Prioriteti i Mesëm

E gjetura Komuna ka 12 automjete zyrtare të cilat i përdor për aktivitetet komunale. Fletudhëtimet nuk janë të plotësuara dhe shpenzimet e ndodhura nuk janë të regjistruar. Përveç kësaj, ka raste kur automjetet zyrtare janë përdorur nga zyrtarët pa miratimin paraprak.

Rreziku Kontrollat jo adekuate mbi përdorimin e automjeteve zyrtare mund të rezultojë në përdorim të paautorizuar dhe shpenzimet shtesë të paplanifikuara të Komunës.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të rishikojë kontrollat ekzistuese mbi përdorimin e automjeteve dhe për përmirësimin e tyre dhe / apo rishikimin mbikëqyrës për të siguruar se përdorimi i automjeteve i përmbahet rregullores për përdorimin e automjeteve të komunës.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 42 mostra ku rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit në Ministrinë e Administratës Publike. Po ashtu, kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientet janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të payrollit dhe listës së pagave. Nuk kemi vërejtur mospërputhje dhe parregullsi të pagesave.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Komuna kishte aprovuar në Kuvendin Komunal Rregulloren për Ndarjen e Mjeteve për Subvencione dhe transfere me datën 03/05/2012. Nga vlera e shpenzuar për subvencione ne kemi testuar 12 mostra me vlerë 2,672€. Dobësitë e gjetura prezantohen në vijim:

Çështja 11 - Subvencionimi i entiteteve publike dhe jo publike - Prioritet i Mesëm

E gjetura Sipas nenit 8 të Rregullores komunale për subvencione, pagesat mbi 500€ duhet të aprovohen nga Kuvendi Komunal. Kryetari i komunës ka autorizuar subvencion për Organizatën jo Qeveritar (OJQ) FWF prej 720€ dhe nuk ishte gjetur marrëveshja e palëve.

Kryetari i komunës i ka dhënë subvencion prej 490€ për OJQ-së "FWF - Shtërpce" për shënimin e ditës botërore të AIDS-it. Nuk ka marrëveshje të shkruar apo dëshmi se si janë shpenzuar këto mjete dhe veprimtaria e OJQ-së nuk ka të bëjë me çështje mjekësore.

Në disa raste komuna ka dhënë subvencione për shënimin e festave familjare. Një përfituesi prej 200€ dhe katër të tjerëve nga 100€ ju kanë dhënë për organizimin e ngjarjes familjare si festa e "Martesës së Kraveviq Markos". Kriteret për dhënie të subvencioneve sipas rregullores janë lidhur me rastet emergjente dhe të domosdoshme e jo këso lloj rastesh.

Rreziku Mos respektimi i rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve mund të rezultojë me pagesa të parregullta dhe aktivitetet e ndërmarra nuk i plotësojnë pritjet / objektivat e komunës.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet t'i shqyrtojë rastet e identifikuar për të përcaktuar se pse kriteret nuk janë aplikuar dhe të zhvillojë kontrolle të zgjeruara për të shmangur përsëritjen e rasteve të tilla.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Në vitin 2013 sipas PVF ishin 119,040€, pasuri të regjistruara në regjistrin kontabël si dhe vlerën 2,662,830€ në regjistrat e sistemit e-Pasuria, gjë që ka demonstruar se komuna ka një regjistër të mbajtur në sistemin e-Pasuria por nuk ka një regjistër të plotë kontabël.

Për më shumë hollësi, shih seksionin 2.2 të këtij raporti

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Komuna inkason lloje të ndryshme të të hyrave vetanake. Në PVF 2013, Komuna ka prezantuar si llogari të arkëtueshme shumë prej 1,023,754€ dhe atë nga tatimi në pronë dhe taksa e veprimtarisë së bizneseve. Çështjet kyçe lidhur me inkasimin e të hyrave janë paraqitur në hollësi në seksionin 4.3

4.5.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2013 ishte 1,093,125€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014. Shumën më të madhe të këtyre obligimeve e përbëjnë shpenzimet kapitale që datojnë nga viti 2011.

Çështja 12 - Borxhet e komunës për projektet e përfunduara - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna gjatë vitit 2010 kishte lidhë kontrata për ndërtimin e objekteve strehimore të personave të strehuar nëpër hotele (1,862,955€), si dhe ndërtimin e një Spitali në Shtërpce (1,382,171€). Vlera totale e kontratave ishte 3,245,126€. Obligimet e faturuara në vitin 2011 ishin 1,019,008€, shumën të cilat janë bartur nga viti në vit dhe nuk janë paguar deri në fund të këtij viti raportues. Këto obligime të mbetura ishin për objektet për nevoja strehimi. Zotimi i fondeve nga Qeveria për këto projekte ishte bërë pjesë-pjesë, dhe jo në shumat e kontraktuara

Rreziku Përkundër pikëpamjeve të menaxhmentit se ndërtimi i këtyre objekteve është i natyrës urgjente dhe prioritare, shuma e borxheve të mbetura është mjaft e lartë dhe mund të sjellë komunën në vështirësi serioze financiare. Ekziston rreziku potencial që operatori të hap kontest gjyqësor për të inkasuar borxhet.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe Qeverinë për të siguruar zgjidhjen e kësaj situatë. Për më tepër, Kryetari i Komunës duhet patjetër të ndërpres praktikën e hyrjes në obligime para se fondet të jenë zotuar.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Komuna ka një auditor ku i njëjti është edhe drejtor njësie. Ai kishte përgatitë planin strategjik tre vjeçar si dhe planin vjetor të auditimit për vitin 2013 i cili është aprovuar nga menaxhmenti i Komunës. Njësia e auditimit të brendshëm (NJAB), për vitin 2013 kishte planifikuar të kryej gjashtë auditime duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut. Përkundër që, nuk ka Komitet të Auditimit (KA), kemi vërejtur se rekomandimet e dhëna nga NJAB janë adresuar dhe ka progres në këtë drejtim.

Çështja 13. -Mungesa e Komitetit të Auditimit- Prioritet i Mesëm

E gjetura Komuna nuk e ka të themeluar KA për monitorim të aktiviteteve të NJAB-së.

Rreziku Mungesa e KA zvogëlon nivelin e sfidës dhe mbështetjes për NJAB duke përfshirë mbështetjen në implementimin e rekomandimeve të tyre.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të sigurojë themelimin e KA, i cili aplikon praktika të mirë dhe të sigurojë se NJAB kryen punën në mënyrë cilësore dhe në pajtim me standardet dhe praktikatat e mira.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;

Të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Pasqyrat Financiare	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se plani sistematik i përpilimit të pasqyrave financiare inkorporon kërkesën për të përfshirë tërë vlerën e pasurive. Është e nevojshme që menaxhmenti të monitorojë zbatimin e kësaj kërkesë.			Nuk ka arritur me implementuar rekomandimin.
2. Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve, me fokus fillestar në ato fusha me rëndësi më të madhe.	Ka pregaditur planin kohor se si mendon me i implementuar rekomandimet		
3. Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari i Komunës duhet të ketë një çasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Kryetari i Komunës duhet të iniciojë një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).		Pjesërisht e ka implementuar këtë rekomandim,	
4. Mos harmonizimi i të hyrave	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të bëhen barazimet e rregullta në mes të departamenteve për gjenerimin e të hyrave dhe Departamentit të financave (të paktën në baza mujore) të mbështetura nga raportet formale, të cilat shpjegojnë arsyen për çdo mospërputhje të identifikuar.	Po ka arritur me implementuar		

<p>5. Shkelje e Procedurave të Prokurimit dhe mbikëqyrje e dobët e projekteve</p>	<p>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha aneks kontratat për punët shtesë të lidhen brenda limitit të përcaktuar me LPP-në. Për punë shtesë që tejkalojnë 10% të kontratës bazë duhet të procedohet me procedura të reja të prokurimit apo përdorimin e procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë. Organet mbikëqyrëse të projekteve duhet t'i forcojnë kontrollet e mbikëqyrjes dhe të konfirmojnë vetëm sasitë dhe cilësinë reale të punimeve.</p>		<p>Pjesërisht</p>	
<p>6. Tejkalim i kontratës</p>	<p>Kryetari i Komunës duhet t'iu bëjë të ditur zyrtarëve të prokurimit dhe të financave se kontratat duhet të respektohen në mënyrë strikte, dhe asnjë furnizim apo pagesë shtesë nuk mund të bëhet jashtë kontrate.</p>	<p>po</p>		
<p>7. Drekat zyrtare</p>	<p>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha faturat për dreka zyrtare të mbështeten me dëshmi shtesë mbi qëllimin e organizimit, numrin e pjesëmarrësve dhe të përmbajnë informata mbi sasinë e paguar.</p>	<p>po</p>		
<p>8. Shpenzimet e telefonit fiks dhe mobil</p>	<p>Kryetari i Komunës duhet të përforcojë kontrollet për shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile. Vendimi për kartelat rimbushëse të telefonave mobil duhet t'i përcaktojë saktë autorizimet për përdorimin e tyre dhe duhet të respektohet çdo pikë e këtij vendimi.</p>	<p>po</p>		
<p>9. Kompensimet (pagat dhe mëditjet)</p>	<p>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që një shqyrtim sistematik i Dosjeve të Personelit do të ndërmerret për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë, brenda një periudhe të specifikuar kohore.</p>	<p>Dosjet janë të kompletuara dhe i përmbushin kërkesat administrative.</p>		

10. Subvencionet dhe Transferet	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të respektohet Rregullorja e brendshme për ndarjen e subvencioneve dhe të gjitha subvencionet trajtohen sipas procedurave të përcaktuara në rregullore, duke përfshirë edhe aspektin e raportimit.			Ende ka nevoj me u shtuar kontrolli
11. Regjistrimi i pasurive në SIMFK dhe E-pasuria	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet që plotësojnë kriteret për t'u regjistruar në SIMFK apo regjistrin e pasurisë, të regjistrohen pa marrë parasysh se përmes cilës formë janë përfituar.			Nuk është implementuar
12. Mungesa e zyrtares për pasuri dhe logjistikë	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që brenda një afati optimal të emërojë zyrtarë të veçantë për pasuri dhe logjistikë. Nevojiten masa të menjëhershme që zyrtarët relevant të fillojnë me identifikimin e gjendjes së saktë dhe regjistrimin e pasurive si dhe vënien e tyre nën menaxhim të plotë.	Janë emëruar		
13. Trajtimi i borxheve	Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të përpilojë një strategji të qartë për mënyrën e shlyerjes së obligimeve të papaguara. Komuna duhet të ketë parasysh disponueshmërinë e fondeve para hyrjes në obligime dhe të bëjë pagesat e faturave brenda afatit ligjor.		Pjeserishtë	
14. Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të fuqizuar misionin e auditimit të brendshëm dhe sistemin e kontrolleve në përgjithësi, ne rekomandojmë Kryetarin e komunës që brenda një periudhe të caktuar kohore të merr në konsiderim themelimin e komitetit të Auditimit të brendshëm.	Ende nuk është themeluar		